



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TIRANË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE  
DREJTORIA E PROKURIMEVE

**Dt.18.10.2021**

## **FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

**Drejtuar: Operatorit Ekonomik “Piano-Bisha” shpk**

**Adresa:** Shkoder Lagjja Vasil Shanto, Rruga Vaso Kadia, nr pasurie 388, zona kadastrale 8593

Procedura e prokurimit/lotit: **Procedurë e hapur e thjeshtuar.**

Numri i procedurës/referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *[Objekti, sasitë dhe kohëzgjatja e kontratës]* **“Shijo produktet lokale të Tiranës” me NR. REF-07535-10-07-2021.** Ky projekt ka si qëllim orientimin e konsumatorit kryeqytetas drejt njohjes dhe përdorimit të prodhimeve lokale vendase nëpërmjet promovimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale si dhe produkteve artizanale.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike Buletini Nr. 148 datë 11 Tetor 2021.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë ka marrë pjesë Ofertuesi i mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- **Operatori ekonomik ”Piano-Bisha” shpk**

**NUIS K86624002A**

Vlera e ofertës– 4.481.600 (katër milion e katërqind e tetëdhjetë e një mijë e gjashtëqind) lekë pa tvsh.

Nuk ka operatorë ekonomikë të s'kualifikuar.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **“Piano-Bisha” shpk**, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 4.481.600 (katër milion e katërqind e tetëdhjetë e një mijë e gjashtëqind) lekë pa tvsh është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Autoriteti Kontraktor në bazë të ligjit nr 162 /2020 per «Prokurimin Publik» neni 97 pika 1, pas përfundimit të procedurës së vlerësimit të ofertave, do të publikojë në sistemin e prokurimit elektronik njoftimin e fituesit.

Me publikimin e njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimit elektronik, operatori i vetëm ekonomik mund të nënshkruajë kontratën konform neni 96 pika 2 gërma (b) pa pritur afate ankimimi sipas përcaktimit të bërë si më poshtë vijon:

*“Periudha e pritjes, e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, nuk zbatohet:*

*a) në rastin e procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës;*

***b) në rastin e procedurave me një ofertues të vetëm, i cili është kualifikuar dhe shpallur fitues;***

**Referuar sa më sipër cituar duke qënë se pjesëmarrs në këtë procedurë prokurimi është një operator ekonomik i vetëm Autoriteti Kontraktor nuk do të presë afate ankimimi.**